

2539
16.05.2016



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E APELIT ADMINISTRATIV
TIRANE

NR.5702/1269/66AKTI

NR.884VENDIMI

VENDIM
NE EMER TE REPUBLIKES

Gjykata e Apelit Administrativ, ne trup gjykues te perbere nga:

Blerona Hasa-----Kryesuese;
Artur Malaj-----Anetar;
Fjoralba Prifti-----Anetare,

asistuar nga sekretare gjyqesore Fiorela Nukaj, sot me date 25.04.2016 ora 11.30, shqyrtoi ne dhome keshillimi, ceshtjen administrative Nr.5702/1269/66 Akti Dt.02.07.2014, me:

PADITESE: Shoqeria tregtare "Guri i Bardhe" sh.p.k.

TE PADITUR: - Drejtoria Rajonale Tatimore, Berat.
- Drejtoria e Apelimit Tatimor.

OBJEKTI: - Shfuqizimi i Njoftim Vleresimit Nr.2303 prot. Dt.29.07.2011 te Drejtorise Rajonale Tatimore Berat.
- Shfuqizimi i Vendimit Nr.16767 prot Dt.23.11.2011 te Drejtorise se Apelimit Tatimor.

BAZA LIGJORE: Nenet 32, 324/a, 331 te K.Pr.Civile, Kodi i Procedurave Administrative, Ligji Nr.9920 Dt.19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne RSH", Ligji Nr.9975 Dt.28.07.2008, i ndryshuar me Ligjin Nr.10280 Dt.20.05.2010, Ligji Nr.10304 Dt.15.07.2010 "Per sektorin minerar", Udhëzimi Nr.26 Dt.04.09.2008 "Per taksat kombetare" i ndryshuar me Udhëzimin Nr.26/1 Dt.26.11.2008 "Per taksat kombetare".

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Berat me Vendimin Nr.741 Dt.15.05.2012, ka vendosur:

"- Rrezimin e padise.
- Shpenzimet gjyqesore ne ngarkim te paditesit.
- Kunder ketij vendimi mund te behet ankim i veçante ne Gjykatën e Apelit Vlore brenda 15 diteve nga e nesermja e shpalljes se ketij vendimi".

Paditesi "Guri i Bardhe" sh.p.k., ka ushtruar kunder ketij vendimi, te drejten e ankimit ne Gjykatën e Apelit Vlore, duke kerkuar ndryshimin e vendimit dhe pranimin e kerkespadise, per keto shkaqe:

Percaktimi i vleres se rentes se pasurise minerare, per te gjitha mineralet, sipas percaktimeve te ligjit, kryhet ne perputhje me percaktimet e bera ne shtojcen nr. 2, qe i bashkelidhet ketij ligji.

Keshilli i Ministrave percakton procedurat e arketimit te rentes minerare dhe dokumentacionin qe duhet te paraqese i licencuari, eksportuesi, per te vertetuar cmimin e shitjes. Ne mungese te ketij dokumentacioni, organi i ngarkuar nga ky ligj per arketimin e takses se rentes minerare, ben rivleresimin, mbeshketur ne metoda alternative".

Neni i mesiperem ngarkon deget e tatimeve per arketimin e rentes minerare ne rastin e shitjeve te produkteve minerare brenda vendit si dhe percakton se Keshilli i Ministrave percakton procedurat e arketimit se rentes minerare.

Ne VKM nr.1306, date 24.09.2008 per disa ndryshime ne VKM nr.1203 date 27.08.2008 "Per Percaktimin e Vleres se Sakte, ne Pergjindje, te Rentes Minerare Sipas Vleres se Tregut, per cdo Minerar apo Grup Mineralesh", pika 2 percaktohet:

- Per te gjitha kategorite e tjera te nenprodukteve minerare, te cilat mund te derivohen nga mineralet e percaktuara ne shtojcen nr.1, qe i bashkelidhet vendimit nr.1203, date 27.8.2008 te Keshillit te Ministrave, dhe per te cilat Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes nuk ka percaktuar normativa korresponduese te mineraleve, qe jane perberes te ketij nenprodukti, kur zoteruesi i lejes se shfrytezimit te mineralit eshte njekohesisht edhe perpunues, renta minerare do te aplikohet mbi koston e prodhimit (nxjerrjes) te mineralit kosto, e cila deklarohet nga prodhuesi dhe paguhet prane organeve tatimore, sipas procedurave te parashikuara ne udhezimin e Ministrit te Financave.

Edhe VKM e permendur me siper percakton se renta minerare do te aplikohet mbi koston e prodhimit te mineralit, kosto e cila deklarohet nga prodhuesi dhe paguhet prane organeve tatimore, sipas procedurave te parashikuara ne Udhezimin e Ministrit te Financave.

Ne Udhezimin nr.26/1, date 20.11.2008 "Per nje ndryshim ne udhezimin nr.26, date 4.09.2008 "Per Taksat Kombetare", pikat 2.4.3 dhe 2.4.4 percaktohet:

Pika 2.4.3

b) Ne rastin kur produkti perfundimtar i shitur eshte perpunuar me tej, vlera e mineralit eshte e barabarte me cmimin e shitjes se produktit perfundimtar gjate muajit kalendarik minus:

- shpenzimet e pasurimit, shkrirjes dhe te rafinimit, qe jane kryer mbi mineralin;

- shpenzimet e transportit nga miniera ne fabriken e pasurimit, shkritore ose impiantet e rafinimit te mineralit;

- te gjitha shpenzimet e tjera, te cilat nuk jane zbritur dhe qe lidhen me koston e pasurimit, shkrirjes ose rafinimit.

2. Cmimi i shitjes nenkupton:

b) Ne qofte se produkti nuk eksportohet, cmimi i shitjes eshte i barabarte me cmimin e shitjes brenda vendit minus:

- shpenzimet e transportit te produktit nga pika e prodhimit deri ne piken e shitjes F.O.B Shqiperi;

- shpenzimet e tjera te shitjes, nese ka te tilla.

Pika 2.4.4 Kur organet doganore apo tatimore konstatojne shmangie te dukshme te vleres se mineralit apo nenproduktit minerar te deklaruar nga subjekti me vleren e tregut, ato do t'u referohen vleres se tregut per llogaritjen e rentes minerare. Vlera e tregut per kete kategori mineralesh apo nenproduktesh, sipas percaktimit te pikes 7 te vendimit e Keshillit te Ministrave nr. 1203, date 27.8.2008, do te nxirret nga nje komision i perbere nga specialiste te Ministrise se Financave, Drejtorise se Pergjithshme te Doganave, Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve dhe Agjencise Kombetare te Burimeve Natyrore. Vlera e tregut, e percaktuar nga ky komision, me pas do te dergohen per miratim prane komisionit ad-hoc, krijuar me vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 686, date 2.11.2005.

Ne keto raste, deget doganore dhe tatimore, per llogaritjen e rentes minerare te produkteve minerare apo nenprodukteve, bazuar ne vlerat e tregut, do t'u referohen vetem

Duke mos qene dakort me sa me siper, tatimpaguesi "Guri i Bardhe" sh.p.k, e ka bere çeshtjen konflikt gjyqesor, duke kerkuar nepermjet kerkespadise se tij, shfuqizimin Njoftim Vleresimi Nr.2303 prot. Dt.29.07.2011 te Drejtorise Rajonale Tatimore Berat dhe te Vendimit Nr.16767 prot Dt.23.11.2011 te Drejtorise se Apelimit Tatimor.

Gjate gjykimit ne shkalle te pare, pala paditese ka pretenduar te njejtat fakte, te konfirmuara edhe ne ankimin e saj kunder vendimit te gjykates se shkalles se pare, pasqyruar ne pjese hyrese te vendimit tone.

Gjate gjykimit ne shkalle te pare, i padituri Drejtoria Rajonale Tatimore Berat, ka prapesuar se:

"Paditesi ushtron veprimtari tregtare me objekt "Prodhim dhe tregetim materialeve te ndertimit.

Vleresimi tatimor objekt padie eshte rezultat i kontrollit te ushtruar sipas vizites fiskale dt.15.07.2011. Nder te tjera objekt i ketij kontrolli tatimor ishte dhe perlllogaritja e rentes minerare per te gjithë sasine e prodhimit te shitur nga dt.01.01.2011 deri ne ditën e kontrollit.

Nga perlllogaritjet rezulton se shoqeria per kete periudhe duhet te paguante 1337.133 leke rente minerare, por ka paguar 137.822 leke. Mbetet diferenca prej 199.311 leke. Eshte llogaritur dhe kamate vonesa ne shumën 5.087 leke dhe gjobe per pagese te vonuar ne vlerën 50.278 leke. Nga DRT Berat eshte nxjerre Njoftim Vleresimi tatimor nr.2303 dt. 29.07.2011 te cilin paditesi e ka ankimuar administrativisht prane DAT Tirane. Kjo e fundit, me vendimin nr. 16767/1 dt. 23.11.2011 ka lene ne fuqi aktin administrative.

Arsyetimi i ketij vendimi, si dhe baza ligjore e cituar ne te, ka qene baza kryesore e parashtrimeve tona ne kete gjykim dhe gjithashtu eshte edhe qendrimi yne perfundimtar per kete ceshtje.

Per me teper bazueshmeria ligjore e akteve administrative u vertetua dhe gjate shqyrtimit gjyqesor, nepermjet provave dhe argumentave te dhena nga perfaqesuesit tane ne kete gjykim.

Sa me siper, bazuar ne nenin 331, paragrafi i pare i Kodit te Procedures Civile, i kerkojme Gjykates te vendose rrezimin e padise pasi aktet administrative jane te drejte e te bazuar ligjerisht".

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Berat, me Vendimin Nr.741 Dt.15.05.2012, ka vendosur rrezimin e kerkespadise, duke argumentuar se:

"Rezulton se padia e paditesit eshte regjistruar ne gjykate ne datën 22.12.2011, pra brenda 30 diteve nga njoftimi i vendimit nr.16767/1 prot. date 23.11.2011 i te paditurit Drejtoria e Apelimit Tatimor prane Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve Tirane drejtuar paditesit "Guri i Bardhe" SHPK.

Sa me siper rezulton nga pohimet e paleve ne gjykim si dhe nga teresia e akteve shkrësore te administruara si prove ne gjykim.

Ne keto rrethana gjykata cmon se padia e paditesit "Guri i Bardhe" SHPK nuk eshte e bazuar ne prova e ne ligj dhe duhet te rrezohet nga gjykata per keto arsye:

Se pari, paraqitja e padise ne gjykate prej paditesit "Guri i Bardhe" SHPK eshte ne perputhje me nenin 109 te ligjit nr. 9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne R.SH", i cili parashikon te drejten e ankuesit ndaj aktit administrativ qe te ushtroje ankimin ne rruge gjyqesore brenda 30 diteve kalendarike nga marrja dijeni i vendimit te organit me te larte administrativ.

Ne piken 2 te nenit 109 te ligjit ne fjale parashikohet se "2. Tatimpaguesi mund te kundershtoje vendimin e drejtorise se apelimit tatimor ne gjykate, brenda 30 diteve kalendarike nga data e marrjes dijeni per kete vendim. Nese drejtoria e apelimit tatimor nuk shprehet brenda

3. Vlerat e perqindjeve, forma, menyra e ndarjes dhe afatet e pageses se rentes minerare percaktohen ne legjislacionin per taksat kombetare".

Ne zbatim te ligjit nr.9975 date 28.07.2008 "Per taksat Kombetare" i ndryshuar, kane dale aktet nenligjore V.K.M nr. 1203 date 27.08.2008, i cili eshte ndryshuar me V.K.M. nr.1306 date 24.09.2008 si dhe Udhezimi i Ministrit te Financave nr.26/1 date 20.11.2008.

Ne V.K.M. nr.1306 date 24.09.2008 parashikohet:

"...3. Ne rastet kur mineralet perdoren per prodhim nenproduktesh (koncentrat minerali apo prodhime metalurgjike), te cilat eksportohen, renta minerare do te aplikohet ne dogane, mbi vleren e mineralit te perdorur per prodhimin e nenproduktit. Kjo vlere do te llogaritet ne baze te faturave te shitjes se sasise se mineralit, te perdorur per prodhimin e nenproduktit. Ne rastin kur eksportuesi i nenproduktit (koncentrat minerali apo prodhime (metalurgjike) eshte njekohesisht edhe prodhues i mineralit, perqindja e rentes minerare do te llogaritet mbi koston e prodhimit (nxjerrjes) te mineralit te perdorur. Kjo vlere percaktohet ne baze te sasise se produktit perfundimtar (koncentrat apo prodhime metalurgjike), te deklaruar ne dogane, si dhe te normativave korresponduese te mineralit te perdorur. Normativat dergohen periodikisht nga Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe te Energjetikes, prane Ministrise se Financave, dhe publikohen ne websaitin e Drejtorise se Pergjithshme te Doganave".

4. Per te gjitha kategorite e tjera te nenprodukteve minerare, te cilat mund te derivohen nga mineralet e percaktuara ne shtojcen nr.1, qe i bashkelidhet vendimit nr.1203, date 27.8.2008 te Keshillit te Ministrave, dhe per te cilat Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes nuk ka percaktuar normativa korresponduese te mineraleve, qe jane perberes te ketij nenprodukti, kur zoteruesi i lejes se shfrytezimit te mineralit eshte njekohesisht edhe perpunues, renta minerare do te aplikohet mbi koston e prodhimit (nxjerrjes) te mineralit, kosto, e cila deklarohet nga prodhuesi dhe paguhet prane organeve tatimore, sipas procedurave te parashikuara ne udhezimin e Ministrit te Financave".

Referuar dispozitave ligjore te mesiperme gjykata çmon se per interpretimin e tyre duhet te zbatohen jo vetem kriteri literal por edhe kriteri funksional e kriteri sistematik i interpretimit te dispozitave, kriteret keto qe qendrojnë ne themel te institutit te interpretimit. Përveç kesaj, gjykata duhet te mbaje parasysh dhe hierarkine ligjore te percaktuar ne kushtetute, sipas te ciles nje akt normativ me fuqi ligjore me te larte ka perparesi ne zbatimin e tij ndaj akteve te tjera normative me fuqi ligjore me te ulet. Per rrjedhim, percaktimet e bera ne lidhje me pagimin e rentes minerare ne piken 4 te nenit 4 te ligjit nr.9975 date 28.07.2008 "Per taksat Kombetare", i ndryshuar si dhe ne ligjin nr.10304 date 15.07.2010 "Per sektorin minerar ne R.SH" marrin perparesi ndaj percaktimeve te bera ne aktet nenligjore te dala ne baze dhe per zbatim te tyre, kjo kur verehen paqartesi apo ndonje mosperputhje midis ketyre percaktimeve.

Ne rastin konkret, menyra e perlllogaritjes se rentes minerare eshte percaktuar qarte nga pika 4 e nenit 4 te ligjit nr.9975 date 28.07.2008 "Per taksat Kombetare", i ndryshuar, ne te cilen ne menyre te shprehur percaktohet se taksa e rentes minerare duhet te perlllogaritet ne baze te "te vleres si siguruar nga shitja e mineralit te papërpunuar, te prodhuar nga zona e lejuar minerare..".

Vlera e siguruar nga shitja e mineralit te perpunuar eshte vlera e faturave te shitjes te deklaruar nga shitesi, ne rastin konkret paditesi "Guri i Bardhe" SHPK. Rastet e parashikuara nga aktet nenligjore te siperpermendura mbi llogaritjen ne baze te koston se prodhimit i referohen situates kur "Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes nuk ka percaktuar normativa korresponduese te mineraleve, qe jane perberes te ketij nenprodukti..".

Ne rastin ne shqyrtim, nuk ka asnje te dhene qe te tregojte se nuk duhet te aplikohet pika 4 e nenit 4 te ligjit nr.9975 date 28.07.2008 "Per taksat Kombetare", i ndryshuar, sipas te ciles vlera e takses duhet te llogaritet mbi bazen e çmimit te fatures.

Gjykata çmon se nga ana e punonjesve te Drejtorise Rajonale te Tatimeve Berat gjate veprimtarise se tyre te emertuar "Vizite fiskale" dhe mbajtjes se procesverbalit date 17.07.2011 mbi te cilin ka dale dhe akti administrativ "Njoftim vleresimi per detyrimet tatimore" nr.2303

Gjykat e Apelit Administrativ veren se paga minimale, sipas VKM-se Nr.573 Dt.03.07.2013 "Per percaktimin e pages minimale ne shkalle vendi", rezulton e percaktuar ne masen 22.000 leke, dyzetfishi i te ciles rezulton ne masen 880.000 leke, shume kjo me e larte ne raport me shumen totale prej 254.676 leke, qe i padituri DRT Berat ka perlllogaritur si detyrime te papaguara nga tatimpaguesi (paditesi) "Guri i Bardhe" sh.p.k.

Shpenzimet gjyqesore lidhur me kete çeshtje ne Gjykatën e Apelit Administrativ nuk u kryen.

PER KETO ARSYE

Gjykata, bazuar ne Nenin 50/b te Ligjit Nr.49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative", unanimisht:

VENDOSI

- Lenien ne fuqi te Vendimit Nr.741 Dt.15.05.2012 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Berat;
- Shpenzime gjyqesore ne Gjykatën e Apelit Administrativ nuk u kryen;
- Kunder vendimit nuk lejohet rekurs ne Gjykatën e Larte.

U shpall sot ne Tirane me 25 te Prillit 2016.

ANETARE
Fjoralba PRIFTI
dv

ANETAR
Artur MALAJ
dv

KRYESUESE
Blerona HASA
dv

E NJEHSUAR ME ORIGJINALIN

Kancelari
Shenket Shkurtaj
Beslaj